



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
KËSHILLI BASHKIAK  
GRAMSH

Nr. 461 / prot.

Gramsh, më 06/05/2020

VENDIM

Nr. 35 Datë. 30/04/2020

**PËR DHËNIE SHPËRBLIMI NGA FONDI REZERVË PËR PËRBALLIMIN  
E SHPENZIMEVE PËR KURIMIN ME TERAPI INTENSIVE**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e radhës datë 30.04.2020 pasi mori në shqyrtim, kërkesën e paraqitur nga **Znj. Klara Hoxha** datëlindja **23.08.1990** nënë e tre fëmijëve minoren, për shkak të një aksidenti dhe sipas dokumenteve në dosjen e këshillit, qytetarja vuan nga dëmtime të eshtrave dhe fraktura në ç2-3 dhe hematoma të shumta. I është nënshtruar operacionit dhe prej disa muaj është regjim shtarti në pamundësi për të lëvizur. Sjellë kërkesën për ndihmë financiare për të përballuar shpenzimet për kurim të mëtejshëm. Këshilli diskutoi për miratimin e përdorimit të pjesshëm nga fondi rezervë të planit të buxhetit 2020, mbështetur në nenin 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligji 9936 datë 26/06/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, të ligjit 10296 datë 08/07/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” ligjin 109 datë 30/10/2017 “Për buxhetin e vitit 2018” si dhe ligjin 139 datë 17/12/2015 “Për vetqeversijen vendore” neni 8 pika 2, neni 9 pika 1.1 gërma “b” neni 54 gërma “dh”;

**VENDOSI:**

- 1- Dhënie e masës së shpërblimit 50.000 (pesëdhjet mijë) lekë, nga fondi rezervë për **Znj. Klara Hoxha**
- 2- Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria Ekonomike.

Ky vendim hynë në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI I KËSHILLIT**

**Endri Mema**

Konceptoi: E.Mema  
Miratoi: G.Lena  
Konfirmoi: G.Lena



**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Greta Lena**